

UNMIK

MISIONI I ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME
TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË
Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

18 dhjetor 1999

UNMIK/PR/116

**PTK nënshkruan kontratën për telefoninë mobile për Kosovën
me "Alcatel"-in dhe Telekomin e Monakos**

Në vijim të tenderit të shpallur nga Posta dhe Telekomunikacionet e Kosovës (PTK) dhe vendimit të UNMIK-ut, të bazuar në rekomandimin e Komisionit të Përbashkët Civil për Postë dhe Telekomunikacione, PTK, më 17 dhjetor 1999, në Paris, nënshkroi kontratën me "Alcatel"-in dhe Telekomin e Monakos, për vendosjen e rrjetit mobil GSM-900 për territorin e Kosovës.

Përfundimi erdhi pas tri ditëve të negociatave në Prishtinë dhe Paris. PTK u përfaqësua nga z. Gerard Fischer, ushtrues detyre i drejtorit gjeneral, i ndihmuar nga ekspertët UNMIK-ut për telekomunikacione dhe ata juridikë. "Alcatel" u përfaqësua nga z. Jean-Michel Lejosne, drejtor i menaxhmentit qendror të projekteve, ndërsa Telekom i Monakos nga presidenti i tij, z. Richard Lalande.

Si operator i rrjetit të telefonisë mobile, PTK - Vala 900, pjesë e PTK-së, do të blejë nga "Alcatel"-i pajisjet e nevojshme për të instaluar rrjetin mobil në territorin e Kosovës me kapacitet maksimal prej 100,000 numrash. "Alcatel"-i është përgjegjës për instalimin dhe startimin e pajisjeve.

PTK and "Alcatel"-i u pajtuan që të fillojnë fazën e parë të vendosjes së rrjetit më 22 dhjetor 1999. Kjo fazë e parë do të ofrojë rrjetin mobil për shtatë qytetet kryesore të Kosovës si dhe për aeroport brenda 12 javësh. Pajisjet emergjente për regjionin e Prishtinës do të instalohen në fillim të vitit që do të thotë se në janar të vitit 2000 do të jetë e mundur të bëhen thirrjet e para telefonike.

Nëpërmjet kësaj kontrate, PTK - Vala 900 do të vendosë sistemet "pre-paid" and "post-paid" për parapaguesit e Kosovës. PTK Vala 900, po ashtu, do të përfitojë nga më shumë se 100 marrëveshje ndërkombëtare të roamingut, duke mundur thirrjet në të gjitha vendet kryesore dhe prodhuar të ardhura përmbajtësore për Kosovën. Të gjitha të hollat e paguara nga kosovarët dhe parapaguesit tjerë lokalë në Kosovë do të mbesin plotësisht me PTK - Vala 900.

Përfundimi i transaksionit do të bëhet më 22 dhjetor 1999 në Shkup.